

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA

PER VITIN KALENDARIK 2017

PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE

Tirane me 26.06.2018

RAPORT I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Drejtuar: *Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*
"Partisë Komuniste të Shqipërisë" Tirane

Te nderuar Zotërinj ,

Në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin Nr.23 datë 27.04.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Per shpalljen e rezultatit të shortit për emerimin e eksperteve kontabel të licencuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga Partitë Politike për vitin kalendarik 2017", dhe në Kontratën e Shërbimit datë 05.06.2018 të lidhur me KQZ, kam kryer auditimin e pasqyrave financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga "Partia Komuniste e Shqipërisë" për vitin kalendarik 2017.

Opinionit

"Partia Komuniste e Shqipërisë" me adresë Rr Durrësit Tirane, ka dorëzuar Formularin e të ardhurave dhe shpenzimeve (pasqyrat financiare) në KQZ, për vitin financiar 2017. Keto pasqyra janë përgatitur mbi bazën e arketim pagesave.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë me datën 31 Dhjetor 2017, aktivitetet dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Në kryerjen e auditimit tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherencë materiale me

pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Partisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Partinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Partisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Partisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Partia të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.
- Ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisje në lidhje me, mes çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Alida Daija (EKR)

Auditues Ligjor

alidadaija@yahoo.com

Rr Ali Pashe Gucia Nr.90

Tirane.


 "ALIDA DAIJA"
 "KOPERTI YNTYABEL"
 "RRENI 01146 110146"

Tirane, më 26.06.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË
Adresa: Rruga "Sotir PEÇI", Nr. 26
TIRANË

Tiranë, më 15-03-2018

Nr. 3/3 Prot.

LËNDA: RAPORTI FINANCIAR VJETOR 2017

**DREJTUAR: KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
TIRANË**

**BAZA LIGJORE: Mbështetur në Vendimin tuaj me Nr. 3, datë 8.01.2011,
po ju parashtrojmë sipas:**

Lidhjes 2 të këtij Vendimi, Raportin Financiar të 2017.

1.1. TË ARDHURAT.

Nr.	Finacimi i buxhetit 2017	Lekë	Euro
1	Gjendja e arkës 2016	194475	100
2	Kuotata e anëtarësisë të Komitetit Qëndror, Kuotat e anëtarësisë së Partisë	533390	
3	Donacionet	-	
4	Të ardhurat nga shtija e gazetës+abonime	144315	
5	Interesi bankar e të tjera		
6	Kontribute për Kongresin e XV-të të PKSH (06.11.2016)		
7	Kontribute për Zgjedhjet Vendore ose Qendrore (18.06.2017)		
	SHUMA	872170	100

Sic shihet nga të dhënat e mësipërme:

1. Financime nga buxheti i shtetit përbën _____% të të ardhurave
2. Donacionet zënë _____%
3. Kuotat e anëtarësisë të Komitetit Qëndror dhe abatarësisë _____100%
4. Qeratë e ambienteve _____%

1.2. SHPENZIMET

1.	Shpenzimet e përditshme për stafin/personelin.	37000
2.	Shpenzime për Energji Elektrike	6000
3.	Shpenzime për Ujë	6000
4.	Shpenzime për Telefon e cel. Postare	5560
5.	Kancelari, kompjuterizim	95440
6.	Interneti – zyrë e PKSH	23170
7.	Karburant, hotele, dieta, udhëtime	67560
8.	Qera (Për Selinë e PKSH-së)	240000
9.	Shpenzime (Kompjuterizimi kalk i Gazetës)	43100
10.	Shpenzime (Botimi i Gazetës)	133000
11.	Shpenzime për postim e transport	23290
12.	Fushata e Zgjedhjeve Qendrore/Lokale	
13.	Shpenzime të ndryshme (Kurora, flamuj, parulla të printuara, foto, etj)	29000
	SHUMA	699020

Për të gjitha shpenzimet vetëm 100 % janë likuiduar nëpërmjet arkës dhe janë të dokumentuara me fatura tatimore dhe kuponin e kasës. Ndërsa 0 % e shpenzimeve janë likuiduar me bankë me dokumentacion të rregullt tatimor.

1.3. AKTIVET DHE PASIVET

1	Selinë e kemi në përdorim me qera	-
2	Mjetet e transportit kanë vlerën fillestare në kontabilitet	-
3	Ky amortizim në vite kap vlerën	-
4	Inventari ekonomik	-

1.3.1. HUA DHE LINJAT E KREDITIT

Gjatë gjithë aktivitetit tonë nuk e kemi praktikuar procesin e huamarrjes si dhe të linjës së kreditit.

Jemi në pritje të çeljes së fondeve të buxhetit për vitin 2018.

KRYEFINANCIER I PKSH-së

SHAHIN ÇAÇA



PERFAQESUESI LIGJOR I PARTISE

NË KQZ

XHEMAL SHEHU